

PROMALT FIXO

Llaç me tkurrje të kompensuar me bazë lidhjesh hidraulike

Karakteristika

PROMALT FIXO është një tretësirë e parapërzier me tkurrje të kompensuar me bazë lidhjesh hidraulike. Produkti është gati për përdorim; i përzier veç me ujë prodhon një tretësirë fluide, pa izolim me karakteristike optimale rrjedhshmërie. Me të kapur, **PROMALT FIXO** arrin qëndrueshmëri të lartë mekanike, me një ngjitje si me çelikon ashtu edhe me betonin, të cilët e bëjnë adapt dhe specifik për ankorimin me përpikmëri të makinerive me dridhje duke iu nënshtuar edhe ndryshimeve të fuqishme termike, përveç ngulitjes së elementeve të parafabrikuar, qoftë të çementuara apo metalike.

Fusha e përdorimit

Solucioni i prodhuar me **PROMALT FIXO**, sugjerohet në mënyrë të veçantë për ankorimin me përpikmëri të makinerive të punës që shkaktojnë dridhje të forta dhe u nënshtohen ndryshimeve termike si turbina dhe alternatorë, kompresorë, presa dhe kalandra (makina me cilindra rrotullues), makine petëzimi qoftë me të nxehtë ose me të ftohtë, makineri thyese për lëndët inerte, makineri për punimin e mermerit, rrotulluese vinçash dhe karro urë, makineri me përdorim të përgjithshëm, struktura metalike, parafabrikate betoni.

Avantazhet

- Ngjeshje mbi çdo majtëse prej çimentoje ose metali
- I patkurrshëm
- Pa agjentë të gaztë që shkaktojnë bymim
- Pa pjesëza metalike
- Pa rrjedhje

Materialet e duhura Beton

Përgatitje e sipërfaqeve

Sipërfaqet duhet të jenë të pastruara dhe pa elemente që mund të çenojnë ngjitjen e solucionit me murin. Lag me kujdes materialin duke eliminuar çdo brrakë uji. Materiale të nevojshme: beton dhe sipërfaqe metalike në përgjithësi.

Mënyrë përdorimi

Për të bërë një kapje sa më të mirë, hedhja nënpiaster duhet bërë pa ndërprerje. Kontrolllo nëse sasia e **PROMALT FIXO** është e mjaftueshme për të kryer gjithë hedhjen (nevojiten rreth 1.800 kg **PROMALT FIXO** për të bërë 1m³ solucion) e që e gjithë atrecatura të jetë e disponueshme dhe ne gjendje për të funksionuar si duhet. Verifiko nëse janë kryer me kujdes të gjitha veprimet lidhur me përgatitjen e betonit, vendosjen e makinës e të kallëpëve të hedhjes (pastëri e lagje). Hidh në betonierë rreth 100% të ujit të përzierjes. Shto shpejt e në mënyrë të vazhdueshme **PROMALT FIXO**. Përziej 2-3 min derisa të shkrihen çdo kokërr, shto ujë për ta bërë fluide sa ti do. Kulloje solucionin shpejt dhe pa ndërprerje për të mundësuar daljen jashtë të ajrit. KUJDES! Gjatë kullimit të solucionit dhe 12 orët vijuese nuk duhet të ketë dridhje në atë zonë e pranë hedhjes. Piq për 2-3 ditë pjesët e ekspozuara me pëlhura të lagëta apo stazhionues filmogjenë.

Të dhëna teknike dhe aplikative

* Pamja	pluhur gri çimento
* Diametri maksimal i inertit	3mm
* Ambalazhimi	thes 25 kg
* Pesha specifike e solucionit të freskët	rreth 2.250 kg/m ³
* Uji i përzierjes	shih tabelën
* Temperatura e aplikimit	+10°C / +25°C
* Koha e ruajtjes	8 muaj nëse mbahet në mjedis të thatë e të freskët në thasët origjinalë të vulosur

PERDORIMI	Uji i përzierjes %	REZISTENCA MEKANIKE (N/mm ²)							
		1 g		3 g		7 g		28 g	
		F	C	F	C	F	C	F	C
Ankorim i strukturave në CLS	15%	8	30	8.7	40	9.5	55	11	70
Ingizim i makinerive	16%	6	25	7.0	36	8	48	9.5	65
Ankorime të mëdha dhe trashësi të vogla	17%	5	23	5.8	30	6.5	42	8.5	58

SHTRIRJE OSE ZGJERIM ME KUNDERVENIE (sipas UNI 8147)

Shtirja me kundërvënie e caktuar për 24 orë, sipas normës UNI 8147 rezulton të jetë $\geq 300\mu$ /metër

Për **PROMALT FIXO** janë të disponueshme kopje të çertifikatave zyrtare përkatëse:

- Prova ngjeshjeje (tërheqje) çelik-beton (sipas UNI 7044 – RILEM-CEB RC 6) çertifikatë ENCO n. 896, më 24/05/2002
- QENDRUESHMERI NE PRERJE (sipas EN 12615 modifikuar sipas procedurës Autostrada) çertifikatë ENCO n. 897, më 24/05/2002

Paralajmërimë

** Mos bëj shtesë/hollim pasi të kesh përgatitur përzierjen

** Të gjitha pjesët e ekspozuara ndaj ajrit duhet të mbrohen nga avullimi e duhet të jenë të staxhionuara për të paktën 2-3 ditë

** Gjatë humbjes së peshës të solucionit e në 12 orët vijuese nuk duhet të ketë dridhje pranë hedhjes

Qëndrueshmëri mekanike: qëndrueshmëritë mekanike të sjella në tabelë janë nxjerrë nga mostra 4 x 4 x 16 cm, të paketuara në laborator me 16% ujë e të pjekur në 20°C dhe U.R. 90%.

VEREJ! Vlerat e lartpërmendura u referohen provave laboratorike në lagështi dhe në temperatura konstante. Këto mund të ndryshojnë në varësi të kushteve termoigrometrike të kantierit.